



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21656 Prot.

Lezhë, më 18.12. 2025

VENDIM

Nr. 123, Datë 15. 12. 2025

**PËR KRIJIMIN E “MUZEUT ARKEOLOGJIK LEZHË”, NË LOKALITETIN E
NJOHUR SI “Qafa e Kalasë” dhe pranë “Nekropolit Mesjetar”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 25, pika 1 e 2 dhe sipas vendimit të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Lezhë "Mbi Organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkise Lezhë dhe Njësive Administrative" Nr. 393. Dt.18.07.2022, në kuadër të projektit “Ndërlidhja e turizmit përmes Trashëgimisë Kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë”, të mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian, në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 66, datë 28.06.2022 “Për miratimin e marrëveshjes së partneritetit të Bashkisë Lezhë me Komunën e Gjakovës dhe Creative Business Solutions (CBS) për zbatimin e projektit “Ndërlidhja e turizmit përmes Trashëgimisë Kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë”, dhe në konfirmimin e këtij vendimi nga Prefekti i Qarkut Lezhë me nr. 451/14 datë 05. 07. 2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi:

1. Krijimin e Muzeut Arkeologjik të Lezhës i cili përbën një domosdoshmëri të kohës dhe një hap thelbësor për:
 - a. Ruajtjen, konservimin dhe ekspozimin e materialeve arkeologjike të zbuluara në territorin e Lezhës dhe zonave përreth
 - b. Dokumentimin shkencor të gjetjeve dhe krijimin e një baze të qëndrueshme studimore për arkeologjinë e Lissit antik dhe të vendbanimeve të tjera në rajonin e Lezhës;
 - c. Zhvillimin e turizmit kulturor, duke e vendosur Lezhën në hartën e destinacioneve kryesore të trashëgimisë në Shqipëri.
 - ç. Fuqizimin e identitetit lokal, përmes ndërgjegjësimit publik mbi vlerat historike dhe arkeologjike të qytetit dhe territorit të Bashkisë Lezhë.
 - d. Përmirësimin e ofertës muzeale dhe turistike, duke krijuar vazhdimësi logjike ndërmjet Memorialit të Vendvarrimit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Mureve të Lissit antik, Akrolisit, Kështjellës së Lezhës, Muzeut Etnografik dhe rrjetit të dendur të monumenteve të zonës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
NDUE LULI**



Nr. 21655/, prot
Dt. 28-12-25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1249/12 Prot.

Lezhë, më 24.12.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma“b“ të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut” i *ndryshuar*, nenin 54 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i *ndryshuar*; konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 123 datë 15.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për krijimin e Muzeut Arkeologjik Lezhë, në lokalitetin e njohur si “Qafa e Kalasë” dhe pranë “Nekropolit Mesjetar”.

PREFEKTI

Taulant MALSHI

